



**FEDERATA E TENISIT TË KOSOVËS**  
**TENISKA FEDERACIJA KOSOVA**  
**TENNIS FEDERATION OF KOSOVA**

[www.tenniskosova.com](http://www.tenniskosova.com); [federation@tenniskosova.com](mailto:federation@tenniskosova.com); 044/14 22 90

## **RREGULLORE PËR TURNE INDIVIDUALE**

### **PËRMBAJTJA**

<b>1. KRITERET KRYESORE .....</b>	<b>1</b>
<b>2. DETYRAT E PERSONAVE ZYRTAR.....</b>	<b>3</b>
<b>3. KONKURRENCAT OBLIGATIVE.....</b>	<b>4</b>
<b>4. TË DREJTË PJESËMARRJE.....</b>	<b>4</b>
<b>5. KUFIZIMET E MOSHËS DHE E DREJTA E PJESËMARRJES .....</b>	<b>5</b>
<b>6. PARAQITJA NË TURNE .....</b>	<b>6</b>
<b>7. PARAQITJA PERSONALE .....</b>	<b>7</b>
<b>8. SHORTI.....</b>	<b>8</b>
<b>9. ORARI DITOR I TAKIMEVE .....</b>	<b>10</b>
<b>10. RANGLISTAT.....</b>	<b>12</b>
<b>11. RREGULLAT E SJELLJES .....</b>	<b>13</b>
<b>12. PIKËT E DËNIMEVE.....</b>	<b>19</b>

### **1. KRITERET KRYESORE**

- 1.1 Rregullorja vendos kriteret të cilat duhet të i përmbushin organizatorët e garave, përmban bazën për vendosjen e propozicioneve të garave, i përshkruan të drejtat dhe detyrat e tenisistëve, referit kryesor të turneut dhe udhëheqësisë së turneut, si dhe dënimet dhe konsekuencat që do të i bartin të lartëshënuarit.
- 1.2 Turnet e FTK-së janë të gjitha turnet individuale dhe ekipore që janë në Kalendarin e garave të FTK-së.

House of Sports,  
Agim Ramadani str,  
10000 Prishtina.  
Kosovo



**FEDERATA E TENISIT TË KOSOVËS  
TENISKA FEDERACIJA KOSOVA  
TENNIS FEDERATION OF KOSOVA**

[www.tenniskosova.com](http://www.tenniskosova.com); [federation@tenniskosova.com](mailto:federation@tenniskosova.com); 044/14 22 90

- 1.3 Për turnet ndërkombëtar vlejné rregullat e organizatës ndërkombëtare në kalendarin e së cilës mbahet ai turne (ITF, Tennis Europe, WTA, ATP).
- 1.4 Turnet e FTK-së mund të i organizojné FTK-ja, klubet e regjistruara pranë FTK-së. Përjashtim janë turnet profesionale të kategorive të seniorëve dhe senioreve, në të cilat organizator mund të jenë edhe organizatat private apo shoqërore.
- 1.5 Organizatori është i detyruar të siguroj:  
Së paku një teren me standarde ndërkombëtare. Nëse ka më shumë se një teren ata duhet të jenë të sipërfaqës së njejtë.
- 1.6 Numër të mjaftueshëm të personave dhe pajisjeve për mirëmbajtjen ditore dhe për pastrimin e terenit në kohën sa më të shkurtër pas ndërprerjes së lojës për shkak të kushteve atmosferike.
- 1.7 Numër të mjaftueshëm të topave. Organizatori është i detyruar që të siguroj për secilin takim të turneut së paku nga dy topa të rinjë.
- 1.8 Numër të mjaftueshëm të referëve
- 1.9 Vend të zbrazët me madhësi 3 x 0.75 m në të dy anët e terenit për nga një reklam të sponzorit të FTK-së.
- 1.10 Të gjitha takimet e kategorive tjera përveq në atë të seniorëve zhvillohen në sistem të fitorës së një tenisti që arrin i pari deri në shtatë (7) gema dhe nëntë (9) gema në finale. Në kategorinë e femrave seniore finalja mund të luhet në dy seta të fituar nëse këtë e përcakton organizatori paraprakisht. Kategoritë e fëmijëve deri 12 vjet mund të luhet në sistemin round-robin.



**FEDERATA E TENISIT TË KOSOVËS  
TENISKA FEDERACIJA KOSOVA  
TENNIS FEDERATION OF KOSOVA**

[www.tenniskosova.com](http://www.tenniskosova.com); [federation@tenniskosova.com](mailto:federation@tenniskosova.com); 044/14 22 90

- 1.11 Organizatori është i detyruar që me kohë (shtatë ditë para turneut) të i dërgoj të dhënat në lidhje me turneun të gjitha klubeve dhe një kopje në FTK. Të dhënat duhet të përmbajnë të gjitha shënimet në lidhje me turneun, duke përfshirë numrin e pjesëmarrësve, afatin e paraqitjes, numrat e telefonit dhe e-mailin e organizatorit, personin kontaktues, si dhe kohën e paraqitjes personale në turne dhe kohën fillimin e turneut.
- 1.12 Organizatori është i detyruar që të siguroj shpërblime për finalistët e të gjitha konkurrencave. Në kategorinë e seniorëve është e lejuar që përveq kupës të jepen edhe shpërblime me para dhe shpërblime praktike. Në kategoritë e juniorëve shpërblimet me para nuk janë të lejuara.
- 1.13 Gjatë kohës kur viti shkollor është duke vazhduar, turnet e kategorive të të rinjëve fillojnë në ditën e shtunë apo ditën e diel.

## **2. DETYRAT E PERSONAVE ZYRTAR**

- 2.1 Referin kryesor të turneut për secilin turne e delegon Këshilli i Referëve të tenisit të Kosovës dhe për këtë e informon organizatorin dhe FTK-në.
- 2.2 Të gjitha takimet individuale i referojnë referët kryesor.
- 2.3 Gjatë gjithë kohës së turneut organizatori është i detyruar që të sigurojë punën e udhëheqësve zyrtar të turneut, me prezencën e së paku një personi zyrtar, si dhe të i vendos informatat në lidhje me orarin e takimeve, informatat tjera relevante si dhe skemën e turneut.



**FEDERATA E TENISIT TË KOSOVËS**  
**TENISKA FEDERACIJA KOSOVA**  
**TENNIS FEDERATION OF KOSOVA**

[www.tenniskosova.com](http://www.tenniskosova.com); [federation@tenniskosova.com](mailto:federation@tenniskosova.com); 044/14 22 90

- 2.4 Udhëheqësit e turneut janë të detyruar të i mundësojnë tenistëve, trenerëve dhe prindërve mundësi të e shiqojnë ranglistën zyrtare të FTK-së në kategorinë përkatëse duke e vendosur ranglistën në vendin informativ të turneut.
- 2.5 Menjëherë pas përfundimit të turneut Referi kryesor i turneut është i detyruar që në FTK të dërgoj me e-mail të skanuar raportin e turneut. Raporti i turneut duhet të përmbajë të gjitha rezultatet e turneut dhe thyerjet e rregullave të sjelljes gjatë turneut.

### **3. KONKURRENCAT OBLIGATIVE**

Të gjitha klubet janë të detyruara të organizojnë nga një turne të secilës kategori (fëmijët 6-10 vjeç, U-12, U-14, U-16, U-18, seniorë, seniore dhe veteranë) gjatë një viti kalendarik.

### **4. TË DREJTË PJESËMARRJE**

- 4.1 Në të gjitha turnet e FTK-së të drejtë pjesëmarrjeje kanë vetëm ata tenistë që janë të regjistruar në bazë të Rregullorës së Regjistrimit të FTK-së, e që nuk janë të dënuar apo të suspenduar.
- 4.2 Në Kampionatet Individuale të Kosovës nuk mund të marrin pjesë shtetasit e huaj Në të gjitha turnet përveq në kampionatet individuale të Kosovës mund të marrin pjesë edhe shtetasit e huaj. Shtetasi i huaj mund të caktohet bartës i turneut nëse ka rangim më të mirë ndërkombëtar se tenisti vendor.



**FEDERATA E TENISIT TË KOSOVËS**  
**TENISKA FEDERACIJA KOSOVA**  
**TENNIS FEDERATION OF KOSOVA**

[www.tenniskosova.com](http://www.tenniskosova.com); [federation@tenniskosova.com](mailto:federation@tenniskosova.com); 044/14 22 90

- 4.3 Të drejtë pjesëmarrje nëpër kategori kanë të drejtë:
- në kategorinë e senioreve dhe seniorëve – të gjithë tenisistët që në vitin kalendarik i mbushin 14 vjet apo më shumë
  - në kategorinë e junioreve dhe juniorëve deri në 18 vjeq – të gjithë tenisistët që në vitin kalendarik i mbushin më së shumti 18 vjet e më së paku 13 vjet
  - në kategorinë e junioreve dhe juniorëve deri në 16 vjeq – të gjithë tenisistët që në vitin kalendarik i mbushin më së shumti 16 vjet e më së paku 12 vjet
  - në kategorinë e vajzave dhe djemëve deri në 14 vjeq – të gjithë tenisistët që në vitin kalendarik i mbushin më së shumti 14 vjet e më së paku 10 vjet
  - në kategorinë e vajzave dhe djemëve deri në 12 vjeq – të gjithë tenisistët që në vitin kalendarik i mbushin më së shumti 12 vjet e më së paku 9 vjet
- 4.4 Tenisti nuk mund që në të njejtën kohë të merr pjesë në më shumë turne se një, dmth që nuk mund të filloj paraqitjen e tij në një turne derisa ende nuk e ka përfunduar paraqitjen në turneun paraprak, sin ë konkurrencën individuale ashtu edhe në ate të dysheve.

## **5 KUFIZIMET E MOSHËS DHE E DREJTA E PJESËMARRJES**

### **U-16**

Tenistët janë të lejuar të luajnë në turnet U-16 nga viti kur i mbushin 13 vjet deri në vitin kur i mbushin 16 vjet.

Tenistët që janë të lejuar të garojnë në kategorinë U-12 nuk janë të lejuar të marrin pjesë në kategorinë U-16.

### **U-14**



**FEDERATA E TENISIT TË KOSOVËS**  
**TENISKA FEDERACIJA KOSOVA**  
**TENNIS FEDERATION OF KOSOVA**

[www.tenniskosova.com](http://www.tenniskosova.com); [federation@tenniskosova.com](mailto:federation@tenniskosova.com); **044/14 22 90**

Tenistët janë të lejuar të luajnë në turnet U-14 nga viti kur i mbushin 10 vjet (i kanë mbushur 10 vjet para fillimit të turneut) deri në vitin kur i mbushin 14 vjet.

## **U-12**

Tenistët janë të lejuar të luajnë në turnet U-12 nga viti kur i mbushin 10 vjet (i kanë mbushur 10 vjet para fillimit të turneut) deri në vitin kur i mbushin 12 vjet.

## **6. PARAQITJA NË TURNE**

- 6.1 Paraqitjen në turne për konkurrencën individuale e bënë klubi amë, tenisti apo tek më të vegjëlit njëri nga prindërit. Paraqitja i dërgohet organizatorit me shkrim nëpërmjet adresës elektronike në afatin që është i caktuar në rregullore.
- 6.2 Secili tenist që merr pjesë në turnet e organizuara nga FTK duhet të paguaj 15 euro regjistrimin në FTK. Me këtë ai merr kartelën e regjistrimit me numrin personal IPIN. Kartela vlen gjatë 1 (një) viti kalendarik
- 6.3 Paraqitja në turne për tenisët deri në kategorinë 18 vjeç është 5 euro. Ndërsa kategoria e seniorëve dhe veteranëve do të paguajnë nga 10 euro. Pagesa për paraqitje në nga secili tenist bëhet tek organizatori pak para fillimit të turneut.
- 6.2 Paraqitja bëhet me anë të kartelës personale të tenistit që lëshohet nga FTK dhe që duhet të përmbajë foton, emrin dhe mbiemrin, vitin e lindjes, klubin dhe numrin e regjistrimit në FTK apo IPIN.



**FEDERATA E TENISIT TË KOSOVËS  
TENISKA FEDERACIJA KOSOVA  
TENNIS FEDERATION OF KOSOVA**

[www.tenniskosova.com](http://www.tenniskosova.com); [federation@tenniskosova.com](mailto:federation@tenniskosova.com); **044/14 22 90**

- 6.4 Afati për paraqitjen e tenistëve duhet të theksohet në rregullorën e turneut por nuk duhet të jetë më i vogël se 2 ditë (48 orë) nga fillimi i turneut.
- 6.5 Tenisti mund të e anuloj paraqitjen në turne në afat më të vogël se 1 ditë (24 orë) para fillimit të turneut. Pas këtij afati tenisti mund të e anuloj paraqitjen në turne vetëm me vërtetim të mjekut, në të kundërtën do të i nënshtrohet dënimit nga neni 11.10.

## **7. PARAQITJA PERSONALE**

- 7.1 Paraqitja personale është akti i vërtetimit të paraqitjes së tenistit në turne të konkurrencës individuale me nënshkrimin në listën e tenistëve mu para shortit dhe fillimit të turneut.
- 7.2 Koha e paraqitjes personale kufizohet në më së paku gjysëm ore (30 min) para fillimit të turneut.
- 7.3 Në rast se në kohën e përfundimit të paraqitjes personale ka tenistë që presin për të u nënshkruar në listën e tenistëve, paraqitja personale shtyhet deri sa ata të nënshkruahen në listë.
- 7.4 Tenistët të cilët në kohën e përfundimit të paraqitjes personale nuk gjenden në vendin e caktuar për paraqitje dhe nuk janë nënshkruar në listën e paraqitjes personale të tenistëve organizatori i shlyen nga lista e tenistëve për turne.
- 7.5 PAGESA PËR PARAQITJEN NË TURNË BËHET ME RASTIN E PARAQITJES PERSONALE.



**FEDERATA E TENISIT TË KOSOVËS**  
**TENISKA FEDERACIJA KOSOVA**  
**TENNIS FEDERATION OF KOSOVA**

[www.tenniskosova.com](http://www.tenniskosova.com); [federation@tenniskosova.com](mailto:federation@tenniskosova.com); 044/14 22 90

- 7.6 Shumën e nevojitur të parave për të gjitha kategoritë e turneve i cakton bordi i FTK-së.

## **8. SHORTI**

- 8.1 Shorti i turneut bëhet një ditë para fillimit të turneut me prezencën e më së paku tre personave të moshës madhore dhe të një tenisit pjesëmarrës.
- 8.2 Organizatori është i obliguar që një ditë para turneut deri në orën 20.00 të i informoj të gjitha klubet me anë të postës elektronike për shortin dhe për orarin e ndeshjeve të së nesërmës në ato konkurrenca ku nuk është e nevojshme që të gjithë tenistët të jenë prezent në orën e fillimit të turneut për shkak të numrit të vogël të tereneve.
- 8.3 Bartësit në short përcaktohen së pari sipas ranglistës së ATP, WTA e pastaj sipas ranglistës së FTK për kategori përkatëse
- 8.4 Në rast se dy tenistë ndajnë vendin e njejtë në ranglistë me short përcaktohet cili nga ta do të jetë bartës.
- 8.5 Numri i bartësve në turne mvaret nga numri i tenistëve në turne. Nëse ka:
- 7 deri 10 tenistë – vendosen 2 bartësa
  - 11 deri 20 tenistë – vendosen 4 bartësa
  - 21 deri 40 tenistë – vendosen 8 bartësa
  - 41 e më shumë tenistë – vendosen 16 bartësa





[www.tenniskosova.com](http://www.tenniskosova.com); [federation@tenniskosova.com](mailto:federation@tenniskosova.com); 044/14 22 90

8.6 Pa marrë parasysh numrin e tenistëve në turne bartësit 1 & 2 vendosen:

- bartësi 1 në vijën e parë të skemës së shortit
- bartësi 2 në vijën e fundit (të poshtme) të skemës

8.7 Shorti i bartësve tjerë:

Bartësit	Madhësia e skemës					
	16	32	48	64	96	128
3 & 4 i pari nga shorti në vijën	5	9	13	17	25	33
i dyti nga shorti në vijën	12	24	36	48	72	96
5,6, i pari nga shorti në vijën	8	12	16	24	32	
7 & 8 i dyti nga shorti në vijën	16	24	32	48	64	
i treti nga shorti në vijën	17	25	33	49	65	
i katëri nga shorti në vijën	25	37	49	73	97	
9,10						
11&12 i pari nga shorti në vijën		7	9	13	17	
I dyti nga shorti në vijën		19	25	37	49	
I treti nga shorti në vijën		30	40	60	80	
I katërti nga shorti në vijën		42	56	84	112	
13,14						
15&16 i pari nga shorti në vijën		6	8	12	16	
I dyti nga shorti në vijën		18	24	36	48	
I treti nga shorti në vijën		31	41	61	81	
I katëri nga shorti në vijën		43	57	85	113	



- 8.8 Në rast se numri i tenistëve është më i vogël se numri i vijave në skemën e turneut, vendet e lira (bye apo pa lojë) caktohen në vijat për takimet më bartësit, duke filluar nga bartësi i parë e më poshtë
- 8.9 Në rast se numri i vendeve të lira në skemën e turneut është më i madh se numri i bartësve vendet e lira (bye apo pa lojë) caktohen me short në të dyja pjesët e skemës.
- 8.10 Në rast se numri i tenistëve të paraqitur në turne është më i madh se madhësia e skemës, por është shumë i vogël për të u luajtur kualifikimet atëherë luhen takimet kualifikuese paralojë. Në këtë rast vendet për takimet paragjiro në skemë duhet të tërhiqen me short përveq në vendet e bartësve.  
Pasi që tërhiqet shorti i bartësve tenistët tjerë tërhiqen me short dhe vendosen me rend nga lartë poshtë në vendet e zbrazëta të skemës, duke përfshirë edhe para gjyrot.

## **9. ORARI DITOR I TAKIMEVE**

- 9.1 Orari ditor i takimeve duhet të jetë i vendosur në një vend të dukshëm në këndin informues dhe nuk mund të ndërrohet pa vendimin e referit kryesor
- 9.2 Orari i takimeve për ditën e nesërme duhet të bëhet sa më shpejt të jetë e mundur por gjithësesi me përfundimin e takimeve të ditës.
- 9.3 Takimet ditore luhen sipas orarit të përcaktuar dhe tenisti i cili në afat prej 15 minutash nga koha kur është thirrur të luaj nuk është i gatshëm të luaj do të



[www.tenniskosova.com](http://www.tenniskosova.com); [federation@tenniskosova.com](mailto:federation@tenniskosova.com); 044/14 22 90

- diskualifikohet, përveq nëse referi kryesor i turneut duke i marrë parasysh të gjitha faktet relevante nuk vendos ndryshe.
- 9.4 Tenisti i cili përveq në konkurrencën individuale merrë pjesë edhe së paku në një të një të konkurrencat e çifteve, takimet individuale i zhvillon para takimeve të çifteve.
- 9.5 Tenisti mund të i luaj më së shumti katër takime në të njëjtën ditë, nga këto më së shumti dy në konkurrencën individuale.
- 9.6 Takimet e kategorive të moshës 12 dhe 14 vjeqare nuk mund të fillojnë pas orës 22.00.
- 9.7 Në temperatura të larta mbi 32 gradë celzijus referi kryesor ka të drejt të i ndërpres takimet deri atëherë kur sipas vlerësimit të tij kushtet të përmirësohen.
- 9.8 Tenisti ka të drejtë pushimi në mes të dy takimeve individuale varësisht nga gjatësia e takimit të parë:
- nëse takimi i parë ka zgjatur më pak se 60 minuta – tenisti ka 30 minuta pushim
  - nëse takimi i parë ka zgjatur prej 60 deri 90 minuta – tenisti ka 60 minuta pushim
  - nëse takimi i parë ka zgjatur mbi 90 minuta – tenisti ka 90 minuta pushim
- 9.9 Para takimit të çifteve tenistët kanë të drejt pushimi prej 30 minutash



[www.tenniskosova.com](http://www.tenniskosova.com); [federation@tenniskosova.com](mailto:federation@tenniskosova.com); 044/14 22 90

9.10 Në rast se në ditën e njejtë duhet të luhen takimet gjysëmfinale dhe takimi final në konkurrencën individuale, dy takimet gjysëmfinale duhet të fillojnë në kohë të njejtë ndërsa pushimi para takimit final duhet të jetë së paku dy orë.

Referi kryesor i turneut i ndërpre në takimet për shkak të territ apo për shkak të motit. Në rast të territ ndërprerja bëhet pas numrit total çift të gemave në set apo pas përfundimit të setit.

9.11 Tenistët kanë të drejtë për 5 minuta nxemje para fillimit të takimit. Në rast e e vazhdojnë takimin e ndërprerë koha e nxemjës është:

Për pushimin më të vogël se 15 minuta – nuk ka nxemje

Për pushimin prej 15 deri 30 minuta – 3 minuta nxemje

Për pushimin mbi 30 minuta – 5 minuta nxemje

## **10. RANGLISTAT**

10.1 Për kategoritë deri në 12 vjeq nuk ka rangim të tenistëve.

10.2 Për të gjitha kategoritë tjera ka rangim dhe vlej në pikët sin ë vijim:

<b>Gjiroja në turne</b>	<b>Pikët</b>
Fituesi	250
Finalisti	180
Gjysëmfinalistët	120
Çerekfinalistët	80
Rrethi i 16	50
Rrethi i 32	30



**FEDERATA E TENISIT TË KOSOVËS**  
**TENISKA FEDERACIJA KOSOVA**  
**TENNIS FEDERATION OF KOSOVA**

[www.tenniskosova.com](http://www.tenniskosova.com); [federation@tenniskosova.com](mailto:federation@tenniskosova.com); 044/14 22 90

Kualifikimet	20
--------------	----

## **11. RREGULLAT E SJELLJES**

- 11.1 Qëllimi i këtyre rregullave është mbajtja e një rendi të qëndrueshëm dhe të sjelljes së mirë të tenistëve të regjistruar pranë FTK-së, të cilët marrin pjesë në turnet individuale dhe ato ekipore gjatë kalendarit të garave të FTK-së
- 11.2 Tenisti, treneri, prindi ose përfaqësuesi i tenistëve nuk guxon në asnjë moment, sidomos gjatë turneut, të sillet në mënyrën që ndikon negativisht për imazhin e FTK-së, duke u sjell keq ndaj organizatorëve të turneut, tenistëve tjerë, referëve apo tenisit në përgjithsi.
- 11.3 Tenisti duhet të sillet në mënyrë sportive gjatë takimit dhe gjatë gjithë kohës sa qëndron në vendndodhjen e turneut.
- 11.4 Nëse ndodh që vjen deri te thyerja e rregullave të sjelljes është detyrë e referit kryesor të turneut që të hetoj me ato mundësi që ka të gjitha faktet në lidhje me ngjarjen dhe të e informoj tenistin për fletëparaqitjen e raportit për thyerjen e rregullave të sjelljes.
- Referi kryesor i takimit e dënon tenistin që nuk sillet sipas rregullave të sjelljes gjatë takimit. Referi kryesor i turneut nëse vërren se një tenist është duke i thyer rregullat e sjelljes ka të drejtë të e dënoj tenistin, nëse këtë nuk e bënë referi kryesor i takimit.



[www.tenniskosova.com](http://www.tenniskosova.com); [federation@tenniskosova.com](mailto:federation@tenniskosova.com); 044/14 22 90

11.5 Sistemi i dënimit shkallë-shkallë gjatë takimit për shkeljet e cekura në nenin ... është si në vijim:

- Shkelja e parë – vërejtje
- Shkelja e dytë – pikë dënimi
- Shkelja e tretë – gem dënimi
- Secila shkelje në vijim – gem dënimi ose diskualifikimi

11.6 Për secilën shkelje dënimi mund të jetë edhe diskualifikimi, dhe për këtë vendos referi kryesor i turneut duke marrë në konsideratë peshën e shkeljes nga tenisti.

11.7 Dënimet i jep referi kryesor i takimit. Nëse referi kryesor i takimit këtë nuk e bënë ose kur referojnë vetë tenistët dënimet i jep referi kryesor i turneut ose ndihmësi i tij. Tenisti duhet të jetë i informuar qartë në lidhje me dënimin e dhënë ndaj tij.

11.8 Pas dënimit të tretë referi kryesor i turneut vendos nëse dënimi për shkeljen e rradhës do të jetë përsëri gem dënimi apo diskualifikimi. Referi kryesor i takimit është i detyruar pas dënimit të tretë të e ftoj referin kryesor të turneut dhe të e informoj në lidhje me dënimin e dhënë, në mënyrë që referi kryesor i turneut me kohë të reagoj në rast të shkeljës së rradhës nga ana e tenistit.

11.9 Rregullat e sjelljes janë:

a) Veshja dhe pajisjet joadekuate

Tenistët janë të detyruar që të paraqiten në takime me veshje të pastër dhe normale. Është e ndaluar paraqitja me majica me mëngë të gjata, T-majica, triko. Për paraqitje me trenerkë nevojitet leja e referit kryesor të turneut.



**FEDERATA E TENISIT TË KOSOVËS**  
**TENISKA FEDERACIJA KOSOVA**  
**TENNIS FEDERATION OF KOSOVA**

[www.tenniskosova.com](http://www.tenniskosova.com); [federation@tenniskosova.com](mailto:federation@tenniskosova.com); 044/14 22 90

b) Largimi nga tereni pa leje

Tenisti nuk mund të largohet nga tereni gjatë kohës së takimit (duke përfshirë edhe nxemjen) pa lejën e referit kryesor të takimit apo të referit kryesor të turneut. Tenisti që e thyen këtë rregull mund të diskualifikohet nga referi kryesor i turneut.

c) Përpjekja më e madhe

Tenisti duhet të bëjë përpjekje të mëdha për të fituar në takim. Nëse këtë nuk e bënë sipas vlerësimit të referit kryesor të takimit dhe atij të turneut, tenisti mund të diskualifikohet nga ana e referit kryesor të turneut.

d) Lënja e takimit

Tenisti duhet të e përfundoj takimin e filluar nëse nuk është lënduar në ndërkohë. Në rast të lëndimit ai duhet të e informoj referin kryesor të turneut mi cili mund të e kërkoj mendimin e mjekut zyrtar.

e) vonesa të panevojshme të lojës

Tenistët janë të detyruar të e fillojnë takimin pas vendimit të referit kryesor pas nxemjes dhe pa ndnjë vonesë të panevojshme të e përfundojnë atë. Në mes të poenave mund të kaloj më së shumti 20 sekonda, përveq gjatë ndërrimit të anëve. Gjatë ndërrimit të anëve prej momentit të përfundimit të poenit të fundit deri në momentin e goditjes së shërbimit të parë të gemit tjetër mund të kaloj më së shumti 90 sekonda. Pas gemit të parë dhe në tie-break tenistët i ndërrojnë anët pa pushim. Pas përfundimit të setit, pa marrë parasysh rezultatin fillon pushimi që



[www.tenniskosova.com](http://www.tenniskosova.com); [federation@tenniskosova.com](mailto:federation@tenniskosova.com); **044/14 22 90**

zgjatë 120 sekonda (2 minuta) prej momentit të përfundimit të poenit të fundit në set deri në momentin e goditjes së topit të parë të setit tjetër. Nëse seti përfundon pas numrit çift të gemave të luajtur, tenistët nuk i ndërrojnë anët pas pushimit.

Pranuesi i shërbimit duhet të e përcjell tempon e lojës së shërbyesit dhe duhet të jetë i gatshëm në momentin kur shërbyesi është i gatshëm të shërbej.

Zvarritja e lojës që vjen si pasojë e humbjes së kondicionit trupor, lëndimit apo refuzimit të vazhdimit të takimit konsiderohet thyerje e këtyre rregullave. Shkelja e parë e këtyre rregullave do të sanksionohet më vërejtje, ndërsa çdo shkelje tjetër me një poen dënimi. Por, kur tenisti nuk e vazhdon takimin edhe pas thirrjes së referit kryesor, atëherë kjo shkelje sanksionohet sipas sistemit të dënimit shkallë-shkallë.

f) shprehjet vullgare

Tenisti nuk mund të përdor shprehje vullgare në teren dhe rreth tij. Nëse shkelja ndodh gjatë takimit tenisti dënohet sipas sistemit të dënimit shkallë-shkallë.

Si shprehje vullgare vlerësohen secila fjalë e përdorur që njihet si shprehje vullgare (fjalë e ndytë), që është thënë nga tenisti me zë dhe është dëgjuar nga referi kryesor, referët e vijave, shikuesit apo mbledhësit e topave.

g) Gjestet e pahijëshme

Tenisti nuk duhet të përdor gjeste të pahijëshme në teren dhe rreth tij. Nëse shkelja ndodh gjatë takimit tenisti dënohet sipas sistemit të dënimit shkallë-shkallë. Si gjestë të pahijëshme vlerësohen secili gjest me duar, reket apo top të cilat konsiderohen si të turpëshme.

h) Keqëpërdorimi i topit





**FEDERATA E TENISIT TË KOSOVËS**  
**TENISKA FEDERACIJA KOSOVA**  
**TENNIS FEDERATION OF KOSOVA**

[www.tenniskosova.com](http://www.tenniskosova.com); [federation@tenniskosova.com](mailto:federation@tenniskosova.com); **044/14 22 90**

Tenisti nuk guxon që në mënyrë të dhunshme apo të zemëruar të e godet topin me reket ose këmbë në teren dhe rreth tij, përveq gjatë qëllimit të justifikuar të fitimit të poenit në lojë. Nëse shkelja ndodh gjatë takimit tenisti dënohet sipas sistemit të dënimit shkallë-shkallë.

Si keqpërdorim i topit vlerësohet secila goditje e qëllimshme e topit përtej rrethojës së terenit, goditje e rrezikëshme apo e pamëshirëshme e topit brenda terenit pa i ditur pasojat.

i) Keqpërdorimi i reketit apo pajisjeve

Tenisti nuk guxon që në mënyrë të dhunshme apo të zemëruar të e hedh reketin apo ndonjë pajisje tjetër në drejtim të ndonjë objekti tjetër në teren dhe rreth tij. Nëse shkelja ndodh gjatë takimit tenisti dënohet sipas sistemit të dënimit shkallë-shkallë.

Si keqpërdorim i reketit apo pajisjeve vlerësohet secila goditje e qëllimshme, e rrezikëshme apo e pamëshirëshme me reket apo me ndonjë pajisje tjetër në drejtim të rrjetës, terenit, karrikës së referit apo ndonjë objekti tjetër të përherëshëm të terenit.

j) Kërcnimi gojor

Tenisti nuk guxon që gojarisht të e sulmoj apo shaj referin, kundërshtarin, shikuesit apo cilindo person tjetër në teren apo rreth tij. Nëse shkelja ndodh gjatë takimit tenisti dënohet sipas sistemit të dënimit shkallë-shkallë.

Si kërcnim gojor vlerësohet secila thënje e drejtuar ndaj referit, kundërshtarit, shikuesit apo cilitdo person tjetër që nënkupton pandershmëri, nënqimim, fyerje apo shpifje.



**FEDERATA E TENISIT TË KOSOVËS  
TENISKA FEDERACIJA KOSOVA  
TENNIS FEDERATION OF KOSOVA**

[www.tenniskosova.com](http://www.tenniskosova.com); [federation@tenniskosova.com](mailto:federation@tenniskosova.com); 044/14 22 90

k) Kërcnimi fizik

Tenisti nuk guxon që të e kërcnoj referin, kundërshtarin, shikuesit apo cilindo person tjetër në teren apo rreth tij. Nëse shkelja ndodh gjatë takimit tenisti dënohet sipas sistemit të dënimit shkallë-shkallë.

Si kërcnim fizik vlerësohet secila prekje e paautorizuar e referit, kundërshtarit, shikuesit apo cilitdo person tjetër.

l) Marrja e këshillave

Tenisti nuk guxon të merr këshilla gjatë kohës së takimit. Nëse shkelja ndodh gjatë takimit tenisti dënohet sipas sistemit të dënimit shkallë-shkallë. Sipas rregullave të tenisit:

- gjatë takimeve ekipore tenisti mund të merr këshilla nga kapiteni i ekipit i cili qëndron në vendin e caktuar gjatë kohës së ndërrimit të anëve në fund të gemit, por jo edhe në tie-break.

Kjo rregull duhet të interpretohet fjalë për fjalë. Referi kryesor i takimit ose i turneut është i deturuar të reagoj menjëherë kur vëren që tenisti është duke pranuar këshilla me gojë ose me shenja.

Referi kryesor i turneut mund të e diskualifikoj tenistin për secilën shkelje individuale ose me sistemin e dënimit shkallë-shkallë. Vendimi i tij është final dhe kundër tij nuk ka ankesë.

Për dënimet e dhëna për shkelje të rregullave të sjelljes gjatë të gjithë turneve të konkurrencave individuale dhe ekipore të kalendarit të FTK-së, ndahen pikët e dënimeve. Dënimet e shqiptuara në bazë të raportit të referit kryesor të turneut i regjistron personi i autorizuar nga Komisioni i Garave.



## **12. Pikët e dënimeve të cilat jepen për shkeljen e caktuar**

a) Diskualifikimi për një shkelje të bërë	6
b) Diskualifikimi me sistemin e dënimeve shkallë-shkallë	5
c) Mosardhja në turne pa paralajmërim	2
d) Diskualifikim për veshje apo pajisje të parregulltë	3
e) Diskualifikim për vonesë në takim	3
f) Diskualifikim për lëshimin e terenit pa leje	3
g) Diskualifikim për mospërpjekje për të fituar	3
h) Diskualifikim për lëshimin e takimit individual pa arsye	3
i) Thyerja e rregullave të sjelljes në teritorinë tereneve	2
j) Për çdo 2 vërejtje në turneun e njejtë	2
k) Për çdo poen dënimi në turne	2
l) Për çdo gem dënimi në turne	2

12.1 Secili tenist që i mbledh 10 pikë dënimi do të suspendohet nga kalendari i garave të FTK-së në periudhë prej 30 ditësh.

12.2 Pikët e dënimit do të fshihen pas një viti nga dita e përfundimit të turneut në të cilin ka ndodh shkelja



**FEDERATA E TENISIT TË KOSOVËS  
TENISKA FEDERACIJA KOSOVA  
TENNIS FEDERATION OF KOSOVA**

[www.tenniskosova.com](http://www.tenniskosova.com); [federation@tenniskosova.com](mailto:federation@tenniskosova.com); **044/14 22 90**

- 12.3 Personi i autorizuar për evidentimin e pikëve të dënimit e lajmëron tenistin dhe klubin e tij amë për suspendimin.
- 12.4 Vendimi për suspendim vjen me automatizëm pas arritjes së raportit të referëve kryesor të turneut dhe është vendim final. Në këtë vendim tenisti nuk ka të drejtë ankese.

## **FEDERATA E TENISIT TË KOSOVËS**

**Prishtinë 12.01.2012**

**Bordi i FTK-së**